

Shqipëria shtrihet në Evropën Juglindore, në perëndim të Gadishullit Ballkanik, në koordinatat gjeografike: 39 16' gjatësi dhe 42 39' gjerësi. Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28.748 km<sup>2</sup>. Gjatësia e vijës kufitare të Republikës së Shqipërisë është 1094 km, nga të cilat 657 km janë vijë kufitare tokësore, 316 km vijë bregdetare, 48-km vijë ndarëse e lumenjve dhe 73 km e liqeneve.

Republika e Shqipërisë kufizohet në veri nga Mali i Zi, në veri-lindje nga Kosova, në lindje me Maqedoninë, dhe në jug dhe jug-lindje ajo kufizohet me Greqinë. Në perëndim, Shqipëria laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Lartësia mesatare është 708 m, dmth dy-here më e madhe se ajo e Evropës. Shqipëria përfshihet në zonën sub-tropikale me lagështirë të Hemisferës Veriore, dhe në zonën me klimë mesdhetare. Kromi, hekur-nikeli, bakri, qymyrguri, nafta dhe gazi janë disa nga mineralet nëntokësore më të rëndësishme që gjenden në Shqipëri.

### Klima

Në zonat bregdetare: Klimë mesdhetare mesatare, dimër i butë dhe i lagësht, verë e nxehtë dhe e thatë.

Në zonat malore: Klimë mesatare kontinentale, dimër i ftohtë dhe i ashpër, verë e lagësht.

### Relievi

Fushor (në Shqipërinë Perëndimore), Pllajor (në Shqipërinë Lindore), Malor (në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore). Maja më e lartë: Mali i Korabit (2,753m). Vija Bregdetare: 362 km.

### Popullsia

3,170,048 (01 Janar 2008) 95% Shqiptare, 3% Greke dhe 2% të tjerë.

Shkalla e rritjes së popullsisë: 1,05% (1999).

Kryeqyteti Tirana (nga viti 1920).